



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE
DREJTORIA EKONOMIKE

Nr. 4005 prot

B.Curri 03/12/2019

Lenda: Lista e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja përfituese për tu strehuar sipas programit social të strehimit, për dhënien e bonuis strehimit.

Baza Ligjore: , Në zbatim të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1/1 shkronja “b”, nenit 24 dhe nenit 54 shkronja “k” dhe nenit 55 pika 2 dhe 6 të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 15, 77/10 të Ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, pika 6 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 574, datë 29.08.2012 I ndryshuar me VKM 384dt 12.06.2019 dhe për “Përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”; dhe VKM 362 date 29.05.2019.”Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qerasë në tregun e lirë nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyren e llogaritjes se tij “

Dokumentacioni që duhet të paraqes familja përfituese për bonus strehimi:

- Vertetim për vendbanimin në njësinë e vetqeverisjes vendore.
- Vertetim nga zyra e ndihmes ekonomike dhe përkujdesjes pran njësisë së qeverisjes vendore për antarët e familjes të përfshire në programin e ndihmes ekonomike dhe pagesëse për personat me aftësi të kufizuara.
- Vertetim nga Zyra e Punës për antarët mbi 18 vjec që figurojnë të papunë.
- Vertetim nga Sigurimet Shoqerore për antarët e familjes që përfitojnë pension .
- Vertetim nga Zyra e regjistrimit të Pasurisë të Paluajtshme se familja apo ndonje antare i sajë nuk disponon banesë në pronsi a ndonjë mjedis që mund të përdoret si i tille.
- Vertetim studenti i cili vërteton që studenti ndjek studimet Universitare.
- Vertetim nga organet tatimore që familjaret nuk kanë biznes privat.
- Vertetim nga Zyra e Regjistrimit të Pasurisë të Paluajtshme se nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për çdo antare të familjes.
- Pas miratimit të Këshillit Bashkiak përfituesit e rinjë që kanë marrë statusin e të pastreh dhe hyn në listën e përfituesve të bonuseve lidhin kontratën e qiradhënies mes pronarit të banesës dhe përfituesit të bonusit sipas procedurave të kodit civil, ju kujtojmë që të pastrehet që e kanë kontratën të lidhur me pronarët duhet ta rinovojnë vetëm pas përfundimit të sajë, Afati i lidhjes së Kontrates nuk mund të jete më i shkurter se një vit.
- Numri i Llogarisë Bankare së Qiradhënsit i **Raiffeisen BANK**
- Afati i dorzimit për dokumentacionin është deri më 20.01.2020

KRYETARI
Rexhe Byberi

